

17/01/2024

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Evadimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore” për nevoja të SRV**

*- Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 24 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.*

**REFERENCE : REF-93267-01-17-2024**

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV):  
90524400-0 / Mbledhja, transporti dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore.

**VLERA E FONDIT LIMIT: 17 500 000 (Shtatembedhjete milione e pesëqind mijë ) Lek  
Pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Spitali Rajonal Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

- Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar;
- Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011 ”Per lejet e mjedisit”, i ndryshuar,
- Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar;
- VKM nr. 178, datë 6.3.2012, “Për incinerimin e mbetjeve”;
- VKM nr. 452, datë 11.7.2012, “Për lëndfilllet e mbetjeve”, i ndryshuar;
- VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores, ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’”;
- Udhëzuesin Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore;
- VKM nr. 229, datë 23.04.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”;
- VKM nr. 371, datë 11.06.2014, “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”;
- VKM nr. 418, datë 25.06.2014, “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”;
- VKM Nr. 418, datë 27.05.2020 ”Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të Planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve 2020–2035”;
- VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”;

## I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a) *Formulari i ofertes ekonomike, sipas shtojces 1.*
- b) *Formulari i sigurimit te ofertes, sipas shtojces 3.*
- c) *Formulari permbledhes i vetedeklarimit, sipas shtojces 9.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale

1. Për metoda dhe teknologji të trajtimit të përcaktuara në Ligjin Nr. 10448, date 14.07.2011 ”Per lejet e mjedisit”, në VKM nr.798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore” dhe në Termat e Referencës se DST, ose teknologji ekuivalente, Operatori Ekonomik duhet të disponoje:

1.a Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) ose të tipit B (me kod III.1.B) së bashku me Akt Miratimin përkatës,si dhe

1.b Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (*Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore*) qe të përfshijne kodet e mbetjeve të rrezikshme si me poshte:

- 18 01 01 - Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03);
- 18 01 03 - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet;
- 18 01 04 - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave nuk kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet (p.sh. veshje, hedhurinat e leukoplasteve, ndërresat, veshje për të asgjësuar, pelena etj.)

2. Per metodën dhe teknologjinë e trajtimit me Incenerim, Operatori Ekonomik duhet të disponoje:

3. 2.a Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës si dhe

4. 2.b Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (*Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore*) ku të përfshihen kodet e mbetjeve të rrezikshme si me poshte:

- 18 01 02 - Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03);

- 18 01 08 - Medikamente citostatike dhe citotoksike;

- 18 01 09 - Medikamente te tjera pervec atyre te permendura ne 18 01 08

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

i ndryshuar si dhe në mbështetje të pikës 5 Menaxhimi i Mbetjeve të Shtojcës 1 Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi të Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", i ndryshuar, Ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit", VKM Nr. 798, date 29.09.2010 "Për miratimin e rregullores, Për administrimin e mbetjeve spitalore", VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, "Për miratimin e katalogut të mbetjeve", Udhëzuesi Kombëtar "Për Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore" dhe sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzuesin Kombëtar "Administrimi i sigurt i Mbetjeve Spitalore", Ligjit Nr. 10081, date 23.02.2009 "Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar dhe VKM Nr. 538 date 26.05.2009 "Për licensat dhe lejet, që trajtohen nga/apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta" e ndryshuar.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë të gjitha Çertifikatat si me poshtë vijon:

3.a ISO 9001:2015 (Sistemi Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalent;

3.b ISO 14001:2015 (Sistemi Menaxhimit të Mjedisit) ose ekuivalent;

3.c ISO 45001:2018 (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punetoreve në punë) ose ekuivalent

Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe brenda afatit të vlefshmerisë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 4/a dhe nenit 44 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. *Me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Bazuar në këto dispozita Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efikasitetit të energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.*

- *ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime më të ulta.*
- *ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit*

*të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.*

- *ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjes me sukses të kontratës së shërbimit objekt prokurimi.*
  - *AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara 3, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.*
4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Akt Miratimin Higjieno –Sanitar respektiv për objektet ku ushtron aktivitetin e trajtimit të mbetjeve spitalore, të leshuar nga ISHSH (Inspektoriati Shendetesor Shtetëror);

**Argumentimi:** Ky kriter bazohet në kërkesat e nenit 10 të Ligjit Nr. 7643 datë 12.12.1992 "Për Inspektimin Sanitar" i ndryshuar, dhe në nenin 10.3 të Kreut IV "Leja Mjedisore dhe Akt Miratimi Higjieno – Sanitar" të VKM Nr. 798, datë 29.09.2010 "Për miratimin e rregullosës për administrimin e mbetjeve spitalore", ku parashikohet: "10.3. Inspektorati Sanitar Shtetëror, pas ekspertimit higjieno-shëndetësor, lëshon akt-miratim higjieno-sanitar për ushtrimin e veprimtarisë".

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël 40% e vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/a, 43 pika 3 dhe 43 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

### **Neni 43 pika 3**

*Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

### **Neni 43 pika 5**

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda dates 31 mars të vitit pasardhës,*

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën, vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, kontratën e shërbimit, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në tëshkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 të nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, në të cilin është percaktuar se: "*Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: ... Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës*".

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Kërkesa e mësipërme është percaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe në piken 4 të nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të percaktuar në nenin e sipërcituar

---

2.3.2. Operatori duhet të ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, apo nëpërmjet çdo mënyre posedimi të njohur nga ligji, minimalisht 2 automjete sipas kërkesave të Specifikimeve Teknike dhe Termave të Referencës të ketyre DST. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

➤ **Për automjet në pronësi:**

- *Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*
- *Leje qarkullimi,*

- Akt – kolaudimi,
- Polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt -Miratimet Higjenosanitare,
- Foto te mjeteve ku te duket qarte targa dhe sinjalistika perkatese.

➤ **Për automjetet që nuk janë në pronësi:**

- Kontratë qiraje ose huapërdorje brenda afatit të vlefshmerise të shoqeruar me aktin e pronesisë së qiradhenesit/pronarit;
- Leje qarkullimi e mjetit;
- Akt kolaudimi;
- Polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet;
- Fotot e mjeteve dhe Akt – Miratimet Higjenosanitare.

**\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e te dhenave te mjeteve nepermjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.**

**Shenim:**

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.**

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset në përputhje me pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 4/ç e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Duke marrë në konsideratë faktin se shërbimi objekt i kësaj procedure prokurimi parashikon ndër elementet e tij edhe transportin nga AK në ambientet e trajtimit të operatorit ekonomik, si dhe te produkti final nga ambientet e operatorit drejt landfillit, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën me qëllim ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Perlllogaritja e numrit minimal të automjeteve të kerkuara eshte bere duke marre parasysh fillimisht, që automjetet që do të përdoren për këtë lloj shërbimi do të jenë të llojit furgona që nuk e kalojnë peshën totale me gjithë ngarkesë 3.500 kg, pasi këto kategori automjete janë të manovrueshme për të qarkulluar në ambientet spitalore. Kapaciteti i zakonshëm i këtyre llojeve automjeteve varion nga 500 kg deri në 1.300 kg.

Përlllogaritja merr në konsideratë faktin që frekuenca e kerkuar e terheqjes eshte javore dhe që OE realizon shërbime edhe në kliente të tjera të shpërndara në territor dhe që në disa raste volumi javor i grumbulluar nga AK mund ta kalojë kapacitetin e vetëm një automjeti, si dhe

nevojat për shërbime që ka herepashere cdo automjet. Gjithashtu për të evituar ndërprerjen e shërbimit për nevoja të AK në raste defektesh,

Nga sa më sipër nevojiten minimalisht 2 Automjete për të kryer shërbimin objekt të Marreveshjes Kuader.

**2.3.3.** Operatori Ekonomik duhet ta ketë jo më pak se 15 persona të punësuar për muajin Dhjetor 2023. Për stafin e punonjësve ofertuesi duhet të paraqesë:

- Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore lëshuar nga administrata tatimore;
- Listëpagesat e deklaruara në organet tatimore për muajin Dhjetor 2023.

**\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e numrit të punonjësve nepermjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.**

**Shënim:**

*Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

**2.3.4.** Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës për kryerjen e të gjitha shërbimeve duke pasur të punësuar dhe regjistruar në listpagesën e muajit Dhjetor 2023 ose me kontratë shërbimi:

- Minimumi 1 (një) Inxhinier Mjedisi

Për këtë OE duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese për secilin nga stafi më sipër :

- Librezë pune
- CV përkatëse
- Kontratë pune/ shërbimi e vlefshme
- Diplomë

**\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e emrit të Inxhinierit nepermjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.**

**Shënim:**



Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”**.

**Argumentimi për kriteret në pikën 2.3.3 dhe 2.3.4:** Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikave 4/b dhe 4/c të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pra që kanë në dispozicion për përmbushjen e kësaj kontrate. Numri i përcaktuar i punonjësve të kërkuar me siper argumentohet si më poshtë:

Punonjës administratë dhe mbështetës (administrator, ekonomist, sekretari-arkive, koordinim) - minimalisht 2

Inxhinier Mjedisi- minimalisht 1

Shofer- minimalisht 2

Punëtor ndihmes (ngarkim-shkarkim) - minimalisht 4

Punëtor për operimin e impianteve dhe makinerive - minimalisht 6

**Sqarim:** Ndarja e mesiperme  **nuk**  është e detyrueshme për tu përmbushur nga OE, por është vlerësuar nga AK thjesht si orientuese për qëllim të përlogaritjes së numrit total të punonjësve të kërkuar dhe për të qene në proporcionalitet të kontratës .

Kërkesa e AK që OE duhet të ketë në stafin e tij Inxhinier Mjedisi ,është vendosur në funksion të realizimit të kontratës duke patur parasysh proceset përkatëse të shërbimit lidhur me Tajtimin dhe Evadimin e Mbetjeve Spitalore bazuar në specifikat e këtij shërbimi.

**2.3.5.** Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/perdorim, apo nepermjet cdo menyre posedimi të njohur nga ligji, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt i ketyre DST, sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe të VKM-se për miratimin e rregullores “Për menaxhimin e mbetjeve spitalore”, (*Rregullorja*) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenerëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

- a. Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) - cope 1 dhe impiant back up ose zëvendësues me të njëjtën metodë;
- b. Impiant për asgjësimin me incenerim - cope 1 dhe impiant back up ose zëvendësues me të njëjtën metodë;
- c. Makineri për larjen e kontenerëve cope 1 dhe makineri back up ose zëvendësuese të tillë (vetëm në rastin kur do të përdoren konteniere të ripërdorshëm);

Per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

- a) Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/përdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);
- b) Të jenë të pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;
- c) Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerisë;
- d) Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë.

**\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e te dhenave konkrete per seicilen pajisje (përfshirë edhe ato back up), nepermjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST, duke përfshirë të dhënat si vijon: emërtimi i impiantit / modeli / kodet e mbetjeve që trajton dhe/ose asgjeson (ato qe jane objekt prokurimi) / Leja dhe Licensa përkatëse ku janë të përfshirë (nga ato të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër**

#### **Shenim:**

*Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me orëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.***

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Në bazë të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores, ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’”, VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, impiantet për realizimin e trajtimit te kategorive te caktuara te mbetjeve spitalore, jane pajisjet baze per realizimin me sukses te ketij sherbimi. Gjithashtu, AK, ne planifikimin e menaxhimit te mbetjeve spitalore, ka parashikuar që në dallim nga kontenitoret per te mprehtat dhe qeset, që janë amballazhi i drejtpërdrejtë i mbetjeve spitalore që duhet të jenë njëpërdorimëshe, kontenitoret plastike te medhenj qe duhet te vihen ne dispozicion nga Operatori Ekonomik fitues që shërbejnë për transferimin dhe transportin e mbetjeve spitalore, duhet te jene shumeperdorimesh dhe kjo nuk eshte nje zgjedhje subjektive e AK, por e ndikuar nga shkaqet ligjore, ekonomike dhe mjedisore sic percaktohet nga neni 6 i Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, neni 7 dhe neni 33 i Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, si dhe në Udhëzuesin Kombëtar për

Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore i nxjerrë në zbatim të VKM nr. 798, datë 29.09.2010, "Për miratimin e rregullores, 'Për administrimin e mbetjeve spitalore'". Pra, AK ne planifikimin e menaxhimit të mbetjeve spitalore, duke kërkuar konteniere plastike të mëdhenj që mund të ripërdoren, ka zbatuar pikërisht parimin e "*minimizimit të prodhimit të mbetjeve*", pasi nëse do të pranonte vetem konteniere njëpërdorimesh që duhet të asgjeshen pas çdo përdorimi së bashku me mbetjet spitalore, do të shumëfishonte volumin e mbetjeve që shkojnë për asgjësim dhe kjo do të ishte në kundërshtim me të gjitha parimet e sipërcituara. Për këto arsye, për kontenieret e mëdhenj që janë shumëpërdorimesh është e nevojshme të garantohet që OE disponon pajisjet dhe lejet e nevojshme për larjen dhe higjienizimin e tyre me qëllim ripërdorimi.

Duke mbajtur në konsideratë, se impiantet do jone në gjendje pune të vazhdueshme, kanë nevojë edhe për periudha mirëmbajtjeje parandaluese ose/dhe korrigjuese, si dhe duke parashikuar që mund të pësojnë difekte të zgjatura në kohë ose edhe të pariparueshme, është vlerësuar e nevojshme që të kërkohet edhe një makineri back up ose zëvendësuese, për secilin impiant me të njejtin kapacitet, në mënyrë që të mos rrezikohet ndërprerja e shërbimit. Kjo edhe sepse, edhe në rast se OE do të zëvendësonte impiantin e difektuar me një të ri, do të merrte sidoqoftë një kohë të gjatë pajisja e tyre me lejet e licensat përkatëse, cka sërish do të shkaktonte ndërprerje me muaj të shërbimit.

Lejet e kërkuara për objektin/et e dhene/a me qera vertetojnë se këto pajisje janë të licensuara për realizimin e procesit të trajtimit të mbetjeve nga organi kompetent. Ky certifikim është detyrim ligjor për të gjitha pajisjet të cilat kryejnë këto lloj procesesh në territorin e RSH dhe jo për pronarin apo personin e tretë ndaj kërkesës është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit në fjalë. Fokusi i kësaj kërkesë është tek impianti dhe jo tek personat e tretë të cilët japin me qera apo huapërdorje.

Ky shërbim do të jetë i vazhdueshëm dhe me dinamika të ndryshme sasiore. Kërkesat për marrjen e mbetjeve javore nuk mund të percaktohen paraprakisht pasi nuk mund të parashikohen gjenerimet sasiore cka do të bente një kalendar të sakte për OE. Afatet kohore për grumbullimin e mbetjeve janë taksative nga pikepamja ligjore dhe të ndryshme sa i takon rrymave të tyre. Rrjedhimisht kjo gjë kërkon me patjetër nga OE grumbullimin e mbetjeve sipas kërkesave të AK në kohë të ndryshme cka e bën këtë shërbim të vazhdueshëm dhe të paparashikueshëm. Një sistem reserve back up do të garantonte vazhdueshmerinë e shërbimit në rast defektesh, mirëmbajtjesh, apo raste të forces madhore (mbi ngarkesë në sasitë) etj.

**2.3.6.** Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt të lejuar nga AKM për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë pa djegie me kodin 19 03 dhe produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë me djegie (incenerimit) me kodin 19 01. Për përmbushjen e këtij kriteri ofertuesit duhet të paraqesin:

- Kontratë /akt marrëveshje me subjektin e licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi të jetë aktive në momentin e dorëzimit të ofertave si dhe një deklaratë për vazhdimësinë e kësaj marrëveshjeje për mbulimin e plotë të kontratës së prokurimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, si dhe duke qene se ne baze te VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores, ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’”, strukturat spitalore si krijues të mbetjeve jane pergjegjes deri ne hallken e fundit te asgjesimit te mbetjeve spitalore qe krijojnë, AK kerkon qe operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë të lidhur me subjekt te autorizuar sipas ligjit per depozitimin e produktit final respektiv që del nga proceset e trajtimit/asgjesimit, e cila duhet te jete aktive dhe e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave dhe ne vazhdimesi te kesaj mareveshje deri ne perfundim te kontrates se mbulimit .

Keto dokumente kerkohen me qellim realizimin me sukses te asgjesimit final te mbetjeve si element mjaft i rendesishem i procesit ku dokumentohet qe OE eshte ne kete fushe aktiviteti dhe e kryen realisht kete lloj sherbimi. Duke patur parasysh abuzimet e ndryshme te cilat i behen ketij procesi, ky kriter eshte mëse i domosdoshem dhe gjithashtu do te kerkohet ne vazhdimesi si pjese e monitorimit te zbatimit te kontrates.

**2.3.7.** Operatori duhet te furnizojë kontenitorët sipas standarteve dhe kërkesave të Specifikimeve Teknike dhe Termave të References. Per te provuar plotesimin e ketij kriteri operatori duhet te paraqese per **secilin lloj kontenitori:**

- Katalog ose skede teknike,

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 4/ç nenit 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion mjetet dhe pajisjet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Në bazë të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores, ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’”, VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, kontenitorët e mbetjeve spitalore jane elemente te domosdoshem ne proceset e menaxhimit te evadimit te mbetjeve spitalore si per mbledhjen, izolimin, grumbullimin, dhe transportimin e tyre.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

### A- SPECIFIKIMET TEKNIKE:

Shërbimet që kërkohen :

Afatet e ekzekutimit: 24 muaj

“Evadimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore”, *Marreveshje kuader me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara me afat 24 muaj .*

| Nr. | Kodi për cdo rryme të mbetjeve | Pershkrimi i mbetjeve për cdo rryme   | Menyra e trajtimit për cdo rryme  | Sasia totale e prashikuar për 24 muaj në kg |
|-----|--------------------------------|---|---|---|
| 1   | 18 01 01                       | Bisturitë, shiringa, instrumenta të mprehtë (përveç 18 01 03)   | Sterilizim, grirje, proces mekanik, ndryshim i formës fizike            |   |
| 2   | 18 01 02                       | Pjesë të trupit e organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03)   | incenerim   |   |
| 3   | 18 01 03                       | Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkohet trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet   | sterilizim ose incenerim  |   |
| 4   | 18 01 04                       | Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave nuk kërkohet trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet (p.sh. veshje, hedhurinat e leukoplasteve, ndërresat, veshje për të asgjësuar, pelena etj.) | Sterilizim, ndryshim i formës fizike në një proces mekanik ose riciklim |   |
| 5   | 18 01 08                       | Medikamente citostatike dhe citotoksike   | incenerim   |   |
| 6   | 18 01 09                       | Medikamente të tjera përveç atyre të përmendura në 18 01 08   | incenerim   |   |

Afatet e ekzekutimit: Nga data e nënshkrimit të MK, deri në 2 vjet (24 muaj).

Për realizimin e shërbimit për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore, bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi, operatori ekonomik duhet të sigurojë:

#### 1- Furnizimin me bazen materiale të nevojshme për realizimin e ndarjes në burim dhe magazinimin provizor të mbetjeve spitalore deri në terheqjen e tyre, sipas kërkesave për secilin kod të mbetjeve spitalore.

Për këtë qëllim, Operatori Ekonomik duhet të vëre në dispozicion të AK, konteniere plastikë, qese plastike, kuti për të mprehtat, kuti kartoni (njëpërdorimshëm) për përmbushjen e ambalazhimit referuar tipologjive të mbetjeve. Baza materiale duhet të jetë sipas standardeve dhe kërkesave të VKM nr. 798 datë 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, të

Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore si dhe të përmbushin kërkesat e përcaktuara nga Organizata Boterore e Shendetesise.

Kompania duhet te realizoje nje furnizim të përshtatshëm në cdo kohe me materiale ndihmese te nevojshme per grumbullimin e perkohshem te mbetjeve.

I. Materialet ndihmese duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

#### **Kuti për të mprehtat (brenda diapazonit 3 – 12 Litra)**

- Të jenë në përputhje me standardin SSH EN ISO 23907 – në variantin më të fundit të përditësuar (ose ekuivalent) “Mbrojtja nga dëmtimi prej objekteve të mprehta - Kërkesat dhe metodat e testimit - Kontenierët (enët) e objekteve të mprehta”.
- Hapja të jetë aq e gjerë sa të lejojë që mbetjet spitalore të hidhen në kuti duke vepruar vetëm me një dorë. Në varësi nga masa e mbetjes spitalore për të cilën është projektuar kutia për të mprehtat, hapja në kushte normale të përdorimit, të pengojë daljen/nxjerrjen e përmbajtjes;
- Nëse janë të pajisur me kapakë të lëvizshëm, të jenë të projektuar në mënyrë të tillë që të mos jetë e nevojshme shtyrja me dorë e materialeve në kuti;
- Të jenë të tilla që të mbyllen në mënyrë të sigurt dhe të mbeten të mbyllura gjatë transportit;
- Pasi janë mbyllur, të gjithë llojet e kutive për të mprehtat të mos lejojnë rrjedhje;
- Të jenë të pajisura me dorezë që nuk është pjesë e pajisjes mbyllëse;
- Të jenë pa përbërje polivinilkloridi (PVC), të ndezshme dhe të djegshme në mënyrë të sigurt (Polypropilene);
- Të jetë e shënuar në mënyrë të dukshme me një vijë horizontale për të treguar kur kutia e të mprehtave është e mbushur ndërmjet 70% dhe 80% të vëllimit të saj maksimal, së bashku me fjalët "KUJDES - MOS E MBUSHNI MBI VIJË";
- Të jenë me ngjyrë të verdhë apo kombinim i të bardhës dhe të verdhës; dhe për të mprehtat e ndotura nga citotoksikë, me kapak ngjyrë të kuq ose të purpurt me simbolin e mbetjeve citotoksike;
- Të shkruhet qartë në to me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa. ku të lexohen qartë fjalët "RREZIK: TË MPREHTA TË NDOTURA" dhe të përmbajnë simbolin e biohazardit në etiketë.

#### **Koshat plastikë (brenda diapazonit 40 – 60 Litra)**

- Të jenë në përputhje me standardin SSH EN ISO 23907 – në variantin më të fundit të përditësuar (ose ekuivalent)
- Të tillë që të mbyllen në mënyrë të sigurtë;
- Rezistent ndaj rrjedhjes, thyerjes nga goditja dhe shpimet;
- Të jenë pa përbërje polivinilkloridi (PVC), të ndezshme dhe të djegshme në mënyrë të sigurt (Polypropilene);
- Të shkruhet qartë në to me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa perkatese sipas pikes II të këtyre Specifikimeve “ETIKETIMI”.

***Shënim: Në rastin e koshave plastikë shumëpërdorimësh, duhet të garantohet larja dhe dezinfektimi i tyre ne makinerinë përkatëse të specializuar dhe te vijne te shoqeruar me qeset plastike perkates***

## II. ETIKETIMI

Çdo enë e mbetjeve spitalore duhet të ketë në pjesën e jashtme të saj një etiketë e cila të përmbajë shenjën ndërkombëtare të Biohazardit sipas modelit me përmasat e specifikuara në më poshtë:

Etiketa të prodhohet me material që u reziston rrezeve UV, ujit dhe të jetë ngjitëse, ose të jetë e stampuar në një pozicion të dallueshëm të enës që lejon që të dhënat në etiketë të lexohen lehtë.

### PËRMASAT E SIMBOLIT

#### Tipi i kontenierit të mbetjeve spitalore

#### Përmasat e simbolit

Për të mprehtat:

- |  |                              |
|--|------------------------------|
| i. me kapacitet prej më pak se 2 litra     | jo më pak se 40 mm x 40 mm   |
| ii. me kapacitet prej 2 litra ose më shumë | jo më pak se 75 mm x 75 mm   |
| iii. të tjerë:                             | jo më pak se 150 mm x 150 mm |



### SIMBOLI NË ETIKETË

Ngjyrat e simbolit të jenë si më poshtë:

Konturet – ngjyrë e zezë

Fusha – ngjyrë e bardhë ose ngjyra parësore e enës

Fjalët dhe karakteret – ngjyrë e zezë

Shenja ndërkombëtare e Biohazardit – ngjyrë e zezë

### PËRMBAJTJA E ETIKETËS

Çdo kontenier i mbetjeve spitalore, pasi mbyllet dhe vuloset, të identifikohet me një etiketë që të vendoset në pjesën e përparme të kontenierit dhe që të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- i. Identifikimin: Mbetje Spitalore
- ii. përcaktimin: “Infektuese”
- iii. fjalën sinjalizuese: Rrezik
- iv. njoftimin e rrezikshmërisë: “Mund të shkaktojë infeksion”

- v. Kodin sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve: 18. ... ..
- vi. Gjendjen: e ngurtë ose të lëngët;
- vii. Datën e fillimit dhe përfundimit të grumbullimit;
- viii. Sasinë në kg ose litra;
- ix. Prodhuesin / Kodin Unik / Adresën / Personin përgjegjës (Emër/mbiemër/firmë / nr.telefoni

**PER ORIENTIM-MODEL ETIKETE:**

|   |   |
|---|---|
| <b>MBETJE SPITALORE</b>   | <b>Infektuese</b>   |
| <b>RREZIK! Mund të shkaktojë infeksion</b>                                    |   |
| <b>RRYMA E MBETJEVE: 18. ... ..</b><br>(sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve) |  |
| <b>GJENDJA: NGURTE</b> <input type="checkbox"/>                               |   |
| <b>LËNGSHME</b> <input type="checkbox"/>                                      |   |
| <b>GRUMBULLIMI I MBETJEVE:</b>  |   |
| <b>DATA E FILLIMIT: ... / ... / 20 ...</b>                                    |   |
| <b>DATA E PËRFUNDIMIT: ... / ... / 20 ...</b>                                 |   |
| <b>SASIA: .....</b> (.....) <b>(kg ose l)</b>                                 |   |
| <b>PRODHUESI: .....</b>   |   |
| <b>KODI UNIK: .....</b>   |   |
| <b>ADRESA: .....</b>  |   |
| <b>PERSONI PËRGJEGJËS:</b><br><b>(emër/mbiemër/firmë) .....</b>               |   |
| <b>Nr. Telefoni: .....</b>  |   |

**Etiketat për vendin e magazinimit të AK**

Kontraktori duhet të sigurojë për AK etiketat që duhet të vendosen dukshëm si shenja e rrezikut në dyer, porta ose mbulesa, sipas modelit të mëposhtëm:



**KUJDES!  
MBETJE SPITALORE**



**Specifikimet**

- |                      |  |   |
|----------------------|--|---|
| <b>1. Materiali:</b> | <b>I durueshëm, rezistent ndaj faktorëve atmosferikë, i padeformueshëm kur vendoset në pozicionin vertikal</b> |   |
| <b>2. Ngjyrat:</b>   | <b>Sfondi<br/>Shenja e Biohazardit<br/>Germat</b>  | <b>i verdhë<br/>e zezë<br/>të zeza</b>  |
| <b>3. Përmasat:</b>  | <b>Pllaka<br/><br/>Shenja e biohazardit<br/>Germat</b>   | <b>lartësia <math>\geq</math> 500 mm<br/>gjatësia <math>\geq</math> 600 mm<br/>lartësia <math>\geq</math> 150 mm<br/>lartësia <math>\geq</math> 40 mm</b> |

**III. Terheqja e mbetjeve nga vendgrumbullimi dhe transportin deri ne vend trajtim.**

Operatori ekonomik duhet të sigurojë grumbullimin e kontenierëve me mbetje në pikat e perkohshme të magazinimit të autoriteteve shëndetësore si dhe transportin e tyre në impiantin e trajtimit me mjetet e posaçme të transportit.

Njekohesisht me grumbullimin e kontenierëve duhet të vihen në dispozicion konteniere të rinj të gatshëm për tu përdorur.

Mjeti i transportit, që shërben për dërgimin e kontenierëve të rinj bosh, nuk duhet të jetë i njëjti me atë që përdoret për grumbullimin e kontenierëve të mbushur me mbetje, pra kontenieret me mbetje dhe kontenieret e rinj bosh nuk mund të transportohen me të njëjtin mjet transporti. Transporti i kontenierëve duhet të kryhet në mënyrë që të sigurohet integriteti dhe pastërtia e tyre, në përputhje me rregullat e higjenes dhe sigurisë.

Automjetet e përdorura për transportin e mbetjeve spitalore duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme:

Çdo automjet që transporton mbetje spitalore të rrezikshme:

1. Duhet të jetë lehtësisht i identifikueshëm gjatë transportimit të mbetjeve me simbolin dallues ndërkombëtar të rrezikut të mbetjes spitalore që transportohet. Simboli të mos jetë më i vogël se 250 mm X 250 mm.
2. Duhet të ketë një panel paralajmërues, të vendosur dukshëm në anën e përparme dhe të pasme të automjetit për të treguar transportin e mbetjeve spitalore. Paneli paralajmërues i rrezikut (Varianti A ose B më poshtë) të jetë në pjesën e përparme dhe të pasme të automjetit të transportit të mbetjeve spitalore në një pozicion që nuk mbulon asnjë dritë, targën ose shënime apo shenja të tjera të kërkuara ligjërisht.

Të dy variantet janë të pranueshme dhe zgjedhja varet kryesisht nga hapësira në dispozicion.


3. Të sigurojë kontakt minimal të njeriut me kontenierët e mbetjeve spitalore gjatë ngarkim-shkarkimit të tyre.
4. Të ketë një ndarje midis kabinës së shoferit dhe trupit të automjetit.
5. Të ketë një sistem të përshtatshëm për sigurimin e ngarkesës gjatë transportit.
6. Të mbahet i kyçur përveç kur ngarkohet dhe shkarkohet.
7. Të jetë projektuar dhe ndërtuar në mënyrë të tillë që të mos lejojë derdhjet e mbetjeve të ngurta dhe të lëngta

#### Specifikimet:


- **Materiali:** pjatë alumini (1-2 mm e trashë)
- **Veshja:** sfond reflektues
- **Ngjyrat:** konturi – i zi  
sfondi – i verdhë  
fjalët – të zeza
- **Përmasat:** fjalët  $\geq 40$  mm në lartësi
- **pjata (Versioni A):** gjatësia  $\geq 200$  mm; gjerësia  $\geq 750$  mm
- **pjata (Versioni B):** gjatësia  $\geq 340$  mm; gjerësia  $\geq 500$  mm

---

#### Varianti A



#### Varianti B



Gjithashtu Operatori Ekonomik duhet të realizojë ngarkimin dhe shkarkimin e koshave/kontenierëve në dhe nga makina e grumbullimit. Personeli i trajnuar dhe caktuar për këto qëllime duhet të përdorë veshje të përshtatshme mbrojtëse si doreza, çizme, përparëse dhe maskat.

#### IV. Dezinfektimin

Operatori Ekonomik duhet të realizojë dezinfektimin:

- Të kontenierëve për magazinimin e përkohshëm të mbetjeve spitalore duhet të dezinfektohen para dhe pas çdo terheqje.
- Mjedisëve për magazinimin e përkohshëm të mbetjeve të caktuara nga AK ku realizohet terheqja e kontenierëve, të cilët duhet të dezinfektohen në intervale të rregullta.

#### V. Trajtimin e mbetjeve spitalore dhe asgjësimin final të produktete të trajtimit, sipas kërkesave të legjislativës në fuqi

Kontraktori, në cilësinë e marrësit të mbetjeve spitalore duhet të jetë i pajisur gjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit me Licencë III 2 B, Leje të Mjedisit të tipit A dhe/ose B sipas kategorise së mbetjeve dhe Akt-Miratim Higjieno-Sanitar, sipas kërkesave ligjore në fuqi.

Trajtimi i mbetjeve spitalore kryhet nga subjektet e licencuar, në impiantet për trajtimin e mbetjeve spitalore të rrezikshme, që duhet të jenë të licensuar dhe të respektojnë kërkesat sipas legjislacionit në fuqi për lejet dhe licencat.

Pajisja me leje mjedisore dhe licensë përkatëse e operatorëve ekonomik dhe impianteve për trajtimin e mbetjeve është kusht për kualifikimin. Lejet Mjedisore përkatëse duhet të përmbajnë të dhëna të detajuara që identifikojnë qartë: metodën e trajtimit, teknologjinë e impianteve, llojin dhe tipin e impiantit, vendndodhjen, kapacitetet, ciklet dhe proceset e punës së impianteve.

A. Trajtimi i mbetjeve spitalore të kryhet me metoda të standartizuara. Proceset bazë për trajtimin e mbetjeve spitalore janë si vijon:

- i. termik: ky proces përdor energjinë termike për të shkatërruar patogjenët në mbetje.
- ii. kimik: ky proces përdor dezinfektantë si dioksid klori i tretur, hipoklorit natriumi, acid peracetik, solucion gëlqereje, gaz ozoni ose kimikate të thata inorganike (p.sh. pluhur oksid kalciumi) për të shkatërruar patogjenët në mbetje.
- iii. mekanik: ky proces përfshin copëtimin, bluarjen, përzierjen dhe ngjeshjen me qëllim përmirësimin e shkallës së transferimit të nxehtësisë, depërtimit të avullit dhe kontaktit me dezinfektantin kimik si dhe për të zvogëluar vëllimin e mbetjeve, për t'i bërë mbetjet e trajtuara të panjohshme ose për të shmangur dëmtimin fizik në rastin e mbetjeve të mprehta të trajtuara. Ky proces nuk mund të shkatërrojë patogjenët, por plotëson proceset e tjera të trajtimit të mbetjeve spitalore të rrezikshme.

B. Llojet e pranueshme të teknologjive për trajtimin e mbetjeve spitalore

a. Teknologjitë termike pa djegie

- i. Autoklavat – trajtimi kryhet përmes nxehtësisë së mbetjeve nga avulli nën presion.
- ii. Sistemet e integruara (ose autoklava të avancuara apo autoklava hibride) - kombinojnë trajtimin me avull me procese të tjera mekanike si ngjeshje, copëtim, grirje, para, gjatë ose pas trajtimit;
- iii. Trajtimi me nxehtësinë e fërkimit - përdor nxehtësinë e fërkimit të plotësuar nga ngrohësit me rezistencë për të nxehur mbeturinat, ndërkohë mbetjet copohen në kokrriza të thata.
- iv. Sistemet e nxehtësisë së thatë – nxehtësia aplikohet pa shtuar avull ose ujë. Mbetjet nxehen nëpërmjet përçimit, konveksionit natyror ose të detyruar dhe/ose rrezatimit termik.

b. Teknologjitë kimike

- i. Hidroliza alkaline - shndërron mbetjet patologjike në një tretësirë ujore të dekontaminuar.

c. Teknologjitë me djegie

- i. Inceneratorët – trajtimi bazohet në procesin e oksidimit të thatë dhe temperaturës së lartë që kthen mbetjet organike dhe të djegshme në lëndë inorganike dhe të padjegshme dhe që rezulton në një reduktim të ndjeshëm të vëllimit dhe peshës së mbetjeve”.

C. Për procesin e trajtimit të mbetjeve spitalore, kontraktori dokumenton dhe regjistron në një regjistër të posaçëm, minimalisht të dhënat e mëposhtme:

- a. numrin e identifikimit të ciklit të trajtimit;
- b. sasinë ditore, llojin e mbetjeve të trajtuara dhe kodin përkatës sipas katalogut shqiptar të mbetjeve;
- c. datën, orën e fillimit dhe mbarimit të ciklit të trajtimit;
- d. temperaturën dhe presionin;
- e. subjektin/vend-depozitimin ku dorëzon për asgjësim tepricat e krijuara nga trajtimi i mbetjeve spitalore dhe të dhënat e kontaktit (emër, mbiemër, adresë, nr. telefoni) të asgjësuesit të këtyre tepricave të mbetjeve spitalore të trajtuara;
- f. Të dhënat për lejen e mjedisit A dhe/ose B, të licencës III.2.B dhe Kodin Unik të asgjësuesit të tepricave të mbetjeve spitalore;

#### D. Asgjësimi i tepricave që rezultojnë nga trajtimi i mbetjeve spitalore

Kontraktori është përgjegjës për tu siguruar për evadimin përfundimtar me asgjësim të tepricave që rezultojnë pas trajtimit të mbetjeve spitalore të rrezikshme sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Procesi i asgjësimit të tepricave, mund të realizohet nga vetë Kontraktori, nëse është i pajisur me Leje Mjedisore dhe Licensën përkatëse për këtë proces, ose nga subjekte të tjera të pajisur me Leje Mjedisore e Licensë përkatëse, me të cilët Kontraktori duhet të ketë kontratë aktive në momentin e dorëzimit të ofertave dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes Kuadër do të jete përgjegjës që të mundesoje që ky shërbim të vazhdojë sipas standarteve dhe rregullave në fuqi.

Tepricat e gjeneruara pas trajtimit të mbetjeve spitalore, që rezultojnë të sterilizuara:

- a) mund të dërgohen për rikuperim në impiantet termike të prodhimit të energjisë;
- b) mund të asgjësohen në impiantet e djegies së mbetjeve urbane ose në impiantet speciale të djegies së mbetjeve;
- c) nëse nuk ka impiante sipas germës a) dhe b), mund asgjësohen në landfille për mbetjet jo të rrezikshme.

Tepricat e gjeneruara pas trajtimit të mbetjeve spitalore, që rezultojnë HI

Hiri nga incineratori dhe tepricat e tjera të ngurta të prodhuara, depozitohen në landfille për mbetje jo të rrezikshme, nëse testet vërtetojnë se nuk paraqesin rrezik sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për mbetjet. Në të kundërt, trajtohen si mbetje të rrezikshme dhe mund të depozitohen në landfille për mbetje të rrezikshme, ose të magazinohen nga Kontraktori deri sa të kontraktojë landfillin e mbetjeve të rrezikshme, ose në pamundësi të disponueshmërisë së një landfilli të mbetjeve të rrezikshme, të realizojë procedurat e nevojshme për eksportin e tyre, dhe ti dokumentojë procesin.

Autoriteti Kontraktor për procesin e asgjësimit të tepricave të mbetjeve spitalore, kur asgjësuesi i tyre është i ndryshëm nga Kontraktori, dokumenton dhe regjistrohen në një regjistër minimalisht të dhënat e mëposhtme:

- a. Të dhënat e kontaktit (emër, mbiemër, adresë, nr. telefoni) të dorëzuesit të mbetjeve spitalore;
- b. Llojin e mbetjeve të trajtuara dhe kodin përkatës sipas katalogut shqiptar të mbetjeve;

- c. Sasinë e dorëzuar të tepricave të mbetjeve (në kg);
- d. Datën e dorëzimit;
- e. Numrin e lejes së mjedisit, numrin e licencës III.2.B dhe Kodin unik të dorëzuesit të tepricave të mbetjeve spitalore të trajtuara të dorëzuara për asgjësim;

Në çdo rast të sipërpërmendur mbahet parasysh parashikimi i nenit 44, të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, për të përjashtuar nga depozitimi në landfill mbetjet spitalore të patrajuara fillimisht në impiante të trajtimit të mbetjeve spitalore.

**Argumentimi:** Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, “b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë” si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

**Njesia e Prokurimit**